

Në përputhje me Kartën Olimpike, ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Kosovë, Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Olimpik të Kosovës ka miratuar Statutin në vijim me 24 Shkurt 2016

STATUTI I KOMITETIT OLIMPIK TË KOSOVËS

PREAMBULA

Komiteti Olimpik i Kosovës (në tekstin e mëtejmë “KOK”), një organizate qe i takon Lëvizjes Olimpike, angazhohet të respektoj dispozitat e Kartës Olimpike dhe Kodin Botëror për Anti-Doping dhe të zbatoj vendimet e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar. KOK angazhohet, në pajtueshmëri me misionin dhe rolin e tij në nivel të vendit, të merr pjesë në aktivitetet e promovimit të paqes dhe femrave në sport.

KOK po ashtu angazhohet të mbështhesë dhe të inkurajoj promovimin e etikes në sport, të luftoj kundër dopingut dhe të demonstroj përgjegjësi për çështjet e ambientit.

NENI 1:

EMERTIMI, STATUSI JURIDIK, JURISDIKCIIONI DHE EMBLEMA

- Emri i shoqatës është Komiteti Olimpik i Kosovës (në tekstin e mëtejmë “KOK”), i themeluar me 27 Maj 1992 dhe i njojur nga KON me 9 Dhjetor 2014.
- KOK-u e ka selinë në Prishtinë, në Republikën e Kosovës.
- KOK-u është organizata më e lartë sportive që qeverisë Lëvizjen Olimpike në Kosovë.
- KOK-u është organizatë jo-qeveritare dhe jo-profitabile me kohëzgjatje të pakufizuar, në formën e një shoqate me status të personit juridik, e cila është e regjistruar në nivel të vendit dhe e shtrinë juridikcionin e tij në territorin e Republikës së Kosovës.
- KOK-u mund të padisë, por edhe të paditet në emër të vet.
- KOK-u operon në pajtim me Kartën Olimpike, me këtë Statut dhe me Ligjet e aplikueshme në Kosovë.
- Përfaqësuesi ligjor i KOK-ut është Presidenti. Çdo korrespondencë e KOK-ut i adresohet Presidentit dhe/ose Sekretarit të Përgjithshëm të KOK-ut.
- Asetet, të hyrat dhe profitet duhet të përdoren ekskluzivisht për qëllimet dhe objektivat e KOK-ut dhe nuk mund të përdoren për të sjellë profite direkte ose indirekte për asnje anëtar të KOK-ut. Kjo dispozitë nuk i pengon anëtarët e stafit të KOK-ut për pranimin e kompensimit ose të pagës si pjesë e kontratës së punës, e as nuk e pengon anëtarin e KOK-ut për rimbursim të shpenzimeve të arsyeshme që rrjedhin nga kryerja e funksionit të tyre.
- KOK-u ka Vulën e vet katrore dhe të rrumbullakët.
- Emblema zyrtare e KOK-ut, e aprovuar nga KON-i, është si në vijim:



11. Flamuri dhe emblema të adaptuara nga KOK-u për përdorim në relacion me aktivitetet e tij, duke përfshirë edhe Lojërat Olimpike, janë subjekt i aprovimit nga KON-i.

**NENI 2:
MISIONI, ROLI, OBJEKТИVAT DHE TË DREJTAT**

1. Misioni i KOK-ut është të zhvilloj, promovoj dhe të mbroj Lëvizjen Olimpike në Kosovë, në pajtueshmëri me Kartën Olimpike.
2. Roli i KOK-ut është:
 - a. Të promovoj parimet fundamentale dhe vlerat e Olimpizmit në Kosovë, në veçanti, në fushën e sportit dhe edukimit, duke promovuar programe edukative Olimpike në të gjitha nivelet e shkollimit, në institucionet dhe universitetet sportive dhe të edukimit fizik, si dhe duke inkurajuar krijimin e institucioneve të orientuara në edukimin Olimpik, siç janë Akademia Olimpike Kombëtare, Muzeu Olimpik dhe në programet tjera duke përfshi ato kulturore e që ndërlidhen me Lëvizjen Olimpike.
 - b. Të siguroj mbikëqyrjen e Kartës Olimpike në Kosovë.
 - c. Të inkurajoj zhvillimin e sportit të përformancës së lartë si dhe sportin për të gjithë në Kosovë.
 - d. Të ndihmoj në trajnimin e administratorëve të sportit.
 - e. Të ndërmerr veprime kundër çdo forme të diskriminimit dhe të dhunës në sport.
 - f. Të miratoj dhe zbatoj Kodin Botëror të Anti-Dopingut, duke siguruar se politikat dhe rregullat e KOK-ut për Anti-doping, të anëtarëve dhe/ose kërkesat për fonde, si dhe procedurat e menaxhimit të rezultateve janë në pajtim me Kodin Botëror për Anti-Doping dhe respektojnë të gjitha rolet dhe përgjegjësitë për Komitetet Olimpike Kombëtare qe janë të listuara brenda Kodit Botëror për Anti-Doping.
 - g. Të inkurajoj dhe të mbështesë masat lidhur me kujdesin mjekësor dhe shëndetin e sportistëve.
3. KOK-u ka autoritetin ekskluziv për përfaqësimin e Kosovës në Lojërat Olimpike si dhe në garat multi-sportive regionale, kontinentale dhe botërore dhe do të themeloj, organizoj dhe do të udhëheqë delegacionet e tyre respektive në ngjarjet dhe garat e tillë. KOK-u do të vendosë në hyrjen e sportistëve të propozuar nga federatat respektive kombëtare. Përzgjedhja e tillë duhet të bazohet jo vetëm në përformancën sportive por, po ashtu edhe në shkathësitë e tyre që shërbejnë si një shembull për sportistët e rinj të vendit. KOK-u duhet të siguroj se propozimet e federatave janë në

harmoni me të gjitha dispozitat e Kartës Olimpike. Për më tepër, KOK-u është përgjegjës për sjelljen e anëtarëve të delegacionit të tij.

4. KOK-u është i obliguar të merr pjesë në Lojërat e Olimpiadës duke i dërguar sportistët.
5. KOK-u ka autoritet ekskluziv të përzgjedh dhe të përcaktoj qytetin i cili mund të aplikoj të organizoj në Kosovë Lojërat Olimpike ose garat multi-sportive regionale, kontinentale dhe botërore, që janë nën patronatin e KON-it.
6. Me qëllim të plotësimit të misionit të tij, KOK-u mund të bashkëpunoj me organet qeveritare dhe të punoj në zhvillimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve harmonike dhe të dobishme me organet qeveritare, me mirëkuptim reciprok dhe në respektim të juridikzionit dhe të përgjegjësisë së çdo entiteti. Megjithatë, KOK-u nuk do të shoqeroj vetën me asnje aktivitet që do të ishte në kontradiktë me Kartën Olimpike. KOK-u po ashtu mund të bashkëpunoj me organizata jo-qeveritare.
7. KOK-u duhet të ruaj autonominë e tij dhe ti rezistroj të gjitha presionet e çdo lloji, duke përfshire por jo duke u kufizuar vetëm në presionet politike, ligjore, religioze ose ekonomike që mund ta parandalojnë nga përshtatja me Kartën Olimpike.
8. KOK-u mund të asistoj federatat sportive kombëtare ose asociacionet të zhvillojnë dhe promovojnë sportin e tyre si dhe sportistët në Kosovë, në kuadër të kornizës së Kartës Olimpike dhe rregullave të aplikueshme të Federatave Sportive Ndërkombëtare përkatëse.
9. Për ti arritur objektivat e tij, KOK-u duhet të kërkoj burime të financimit në mënyrën që është në pajtim me Kartën Olimpike.
10. KOK-u mund të bashkëpunoj me Komitetet tjera Olimpike Kombëtare.
11. KOK-u mund të themeloj nën-komisione të veçanta ose Komisione për të ndihmuar në realizimin e detyrate të tij në kuadër të juridikzionit të tij.
12. KOK-u mund të përdorë simbolin Olimpik, Flamurin, moton dhe himnin (që janë pasuri ekskluzive e KON-it) vetëm në kuadër të aktiviteteve të tij jo-profitabile, duke siguruar se përdorimi i tillë kontribuojnë zhvillimin e Lëvizjes Olimpike dhe nuk shmanget nga dinjiteti i tij dhe siguron se ai paraprakisht ka marr aprovimin e KON-it, në pajtim me Kartën Olimpike. Të gjitha pasuritë, duke përfshirë por pa u kufizuar, simbolin Olimpik, flamurin, moton himnin, identifikimet (duke përfshirë por pa u kufizuar në "Lojërat Olimpike" dhe "Lojërat e Olimpiadës"), dizajnimet, emblemat, flakën dhe pishtarin, dhe të gjitha të drejtat ndaj pasurisë Olimpike, veç e veç dhe në tërësi, si dhe e drejta për përdorimin e tyre, i takojnë ekskluzivisht KON-it. KOK-u është përgjegjës ndaj KON-it për mbikëqyrjen në Kosovë të Rregullës 7-14 dhe akteve nënligjore 7-14 të Kartës Olimpike. Ai do të merr hapa të ndaloj përdorimin e pasurisë Olimpike, cilësdo qoftë, që do të ishte në kontradiktë me Rregullat e tilla dhe aktet nënligjore. Ai po ashtu do të angazhohet të mbroj pasurinë Olimpike të KON-it, për të mirën e KON-it.

B. H

13. KOK-u do të ushtroj të gjitha autorizimet, të drejtat dhe obligimet e një Komiteti Olimpik Kombëtar ashtu si i janë dhënë nga Karta Olimpike dhe nga KON-i.

NENI 3: ANETARSIMI

1. Në harmoni me Kartën Olimpike, KOK-u duhet të përfshijë si anëtar votues:

- a. Çdo anëtar të KON-it nga Kosova. Anëtari i tillë, nëse ekziston, duhet të ketë të drejtën të votoj në Asamblenë e Përgjithshme të KOK-ut dhe duhet të jetë anëtar ex-officio i Bordit Ekzekutiv të KOK-ut me të drejtën e votës.
- b. Të gjitha federatat kombëtare të anëtarësuara në Federatat Ndërkombëtare që drejtojnë sportet e përfshira në programin e Lojërave Olimpike. Vërejtje: Përfaqësuesit e këtyre federatave duhet të përbejnë shumicën votuese të Asamblesë së përgjithshme të KOK-ut.
- c. Federatat kombëtare të anëtarësuara në Federatat Ndërkombëtare të njoitura nga KON-i, sportet e të cilave nuk janë të përfshira në programin e Lojërave Olimpike.
- d. Një numër i kufizuar (jo me shume se 6) i organizatave sportive kombëtare të anëtarësuara në Federatat tjera ndërkombëtare, bazuar në vendimin e KOK-ut.
- e. Së paku dy përfaqësues të zgjedhur të sportistëve. Këta përfaqësues të zgjedhur duhet të kenë marr pjesë në, së paku, njëren nga tri edicionet e Lojërave Olimpike. (Vërejtje: kjo kërkesë do të aplikohet vetëm pas pjesëmarrjes së parë të KOK-ut në Lojerat Olimpike).

2. Përveç kësaj, KOK-u mund të përfshijë si anëtar pa të drejtë vote:

- a. Një numër të kufizuar grupeve multi-sportive dhe i organizatave tjera të orientuara në sport ose përfaqësuesit e tyre, si dhe qytetarët e Kosovës të aftë të përforcojnë efektivitetin e KOK-ut ose të cilët kanë kryer shërbime të jashtëzakonshme për kauzën e sportit dhe të Olimpizmit.

3. Kualifikimet për anëtarësim:

- a. Anëtaret dhe/ose përfaqësuesit e entiteteve anëtare të KOK-ut duhet të plotësojnë kushtet në vijim:
 - i. Të jenë qytetarë të Kosovës.
 - ii. Të gjëzojnë të drejtat dhe të mos kenë kryer akte kriminale.
 - iii. Të jenë themeluar ligjërisht dhe të jenë të anëtarësuar në Federatat përkatëse Ndërkombëtare (për federatat kombëtare).
 - iv. Të veprojnë në pajtueshmëri me Kartën Olimpike, me Kodin e KON-it për Etike, me Kodin Botëror për Anti-Doping dhe me këtë Statut.
- b. KOK-u nuk do të njeh më shumë se një federatë kombëtare për çdo sport të drejtar nga një Federatë Ndërkombëtare.
- c. Për tu njojur nga KOK-u dhe për tu pranuar si anëtar i KOK-ut, një federatë kombëtare duhet të realizoj aktivitete sportive të veçanta, reale dhe të vazhdueshme, të jetë e anëtarësuar në një Federatë Ndërkombëtare e njojur

B. H

- nga KON-i dhe të jetë e drejtuar në pajtueshmëri dhe në çdo aspekt, me të dyja, me Kartën Olimpike dhe me rregullat e federatës së saj ndërkombëtare.
- d. Qeveria dhe autoritetet tjera publike nuk mund të emërojnë asnjë anëtar të KOK-ut.
 - e. Një anëtar i përjashtuar nga KON-i nuk mundet me qenë anëtar i KOK-ut.
 - f. Anëtarët e KOK-ut, përveç administratorëve profesional sportiv, nuk do të pranojnë asnjë kompensim apo bonuse të çfarëdo lloji në konsideratë për shërbimet e tyre ose për performancën e detyrës se tyre. Ata mund të rimbursohen për udhëtime, akomodime dhe shpenzime tjera të arsyeshme që burojnë nga kryerja e funksionit të tyre.

4. Aplikimi për anëtarësim:

- a. Aplikacionet për anëtarësim në të shkruar duhet të dorëzohen të Bordi Ekzekutiv i KOK-ut për shqyrtim dhe, nëse aplikanti përmbus hë kërkesat e këtij Statuti, aplikacioni dorëzohet në Asamblenë e përgjithshme të radhës përvlerësim dhe vendim.
- b. Dosja e aplikimit duhet të plotësoj kriteret e formuara nga KOK-u në pajtim me ketë Statut dhe duhet të përfshijë të gjitha dokumentet e nevojshme.
- c. Titulli Anëtar i Nderit mund tu jipet nga Asambleja e përgjithshme (pas propozimit të Bordit Ekzekutiv) për personat që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për Lëvizjen Olimpike dhe për sportin në Kosovë.

5. Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve:

- a. Anëtarët votues kanë të drejtë të votojnë, të zgjedhin, të jenë të zgjedhur dhe të nominojnë anëtarët për zgjedhje në organet drejtuese të KOK-ut.
- b. Anëtarët Jo-votues mund të përcjellin mbledhjet e Asambleve të përgjithshme me të drejtën vetëm të diskutojnë.
- c. Anëtarët kanë të drejtë të jenë rregullisht të informuar për aktivitetet e KOK-ut dhe kanë për detyrë që rregullisht të informojnë KOK-un për aktivitetet e tyre.
- d. Anëtarët mund të përfitojnë nga mbështetja dhe asistenca e KOK-ut për zhvillimin e aktiviteteve të tyre, nëse është e nevojshme dhe nëse kërkohet, dhe është subjekt i juridikzionit, mundësive, mjeteve dhe vendimit të KOK-ut.
- e. Anëtarët aktivisht duhet të marrin pjesë në punën, mbledhjet dhe aktivitetet e KOK-ut.
- f. Anëtarët duhet të respektojnë dhe të zbatojnë vendimet/rezolutat e sjella nga organet e KOK-ut.
- g. Anëtarët duhet të veprojnë në pajtim me Kartën Olimpike, me Kodin e KON-it për Etikë, me Statutin e KOK-ut dhe (për personat juridik), si dhe me rregullat dhe Rregulloret e tyre.
- h. Federatat Kombëtare do të punojnë ngushtë së bashku me KOK-un, në veçanti përgatitjen dhe përzgjedhjen e sportistëve të Kosovës për Lojërat Olimpike dhe garat multi-sportive regionale, kontinentale dhe botërore nën patronatin e KON-it.
- i. Anëtarët do të ushtrojnë çdo të drejtë dhe detyrë tjetër në pajtim me këtë Statut dhe me Kartën Olimpike.

6. Ndërprerja e anëtarësisë:

6.4

- a. Një anëtar mund ti ndërpritet anëtarësia në rast të:
 - i. Vdekjes;
 - ii. Dorëheqjes;
 - iii. Humbjes se kapacitetit;
 - iv. Humbjes se kualifikimit për anëtarësim;
 - v. Shpërndarjes së federatës/shoqatës;
 - vi. Pas përjashtimit, nëse anëtar ka thyer kartën Olimpike dhe këtë Statut.

7. Masat dhe sanksionet:

- a. Kur një anëtar ka dështuar ti përbush detyrat e tij, ka thyer Kartën Olimpike dhe/ose Kodin për Etikë të KON-it dhe/ose statutin e KOK-ut ose nuk ka respektuar dhe nuk ka zbatuar vendimet/rezolutat e organeve kompetente drejtuese të KOK-ut, anëtar mund të jetë subjekt për masat dhe sanksionet në vijim (në varësi të peshës së fakteve dhe nivelit të dëmtimit ose nivelit të thyerjes):
 - i. Vërejtje
 - ii. Suspendim
 - iii. Përjashtim
- b. Vendimi për të lëshuar një vërejtje duhet të merret nga Bordi Ekzekutiv, pasi ti jipet mundësia anëtarit në fjalë që të dëgjohet. Bordi Ekzekutiv do të raportoj për rastin në mbledhjen e radhës të Asamblesë së Përgjithshme.
- c. Vendimi për suspendimin e anëtarit duhet të merret nga Bordi Ekzekutiv pasi ti jipet mundësia anëtarit në fjalë që të dëgjohet. Vendimi i tillë duhet të merret nga së paku dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të Bordit Ekzekutiv. Bordi Ekzekutiv do të raportoj për rastin në mbledhjen e radhës së Asamblesë së Përgjithshme. Anëtar i fjalë mund të vendos të ankohet në Asamblenë e Përgjithshme e cila, në këtë rast, duhet të vendos të konfirmoj vendimin e Bordit Ekzekutiv ose të anuloj suspendimin.
- d. Vendimi për përjashtim të një anëtarari duhet të bëhet nga Asambleja e Përgjithshme dhe pasi ti jetë dhënë një mundësi e arsyeshme që të dëgjohet anëtar i fjalë. Një vendim i tillë duhet të merret me shumicën e votave, nga së paku dy të tretat (2/3) e votave të delegatëve me të drejtë vote dhe prezent në Asamblenë e Përgjithshme.

8. Regjistri i anëtarëve:

Një regjistër i anëtarëve duhet të formulohet dhe të mbahet i përditësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Ky regjistër duhet, në veçanti të përfshijë, informatat në vijim: emrin dhe adresën e anëtarit; datën e anëtarësimit (dhe kopjen e vendimit / procesverbalin e Asamblesë së Përgjithshme në të cilën i është dhënë anëtarësia); kategoria e anëtarësisë; statusi i anëtarësisë. Ky regjistër duhet të jetë në disponim në çdo kohë dhe duhet, në veçanti, të shërbejë si referencë për thirrjen e mbledhjeve të KOK-ut.

B.H.

NENI 4: ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të KOK-ut duhet të jenë si në vijim:

1. Asambleja e Përgjithshme, e cila është organi suprem vendim-marrës i KOK-ut.
2. Bordi Ekzekutiv, i cili është organ menaxhues dhe ekzekutiv i KOK-ut.

NENI 5: ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

1. Perbërja e Asamblesë së Përgjithshme:

a. Perbërja e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jetë si në vijim:

- i. Anëtari(ët) e KON-it nga Kosova, nëse ka, me të drejtë vote.
- ii. Tre përfaqësues (dy meshkuj e një femër ose anasjelltas) nga çdo federatë kombëtare që janë anëtarë të Federatave Ndërkombëtare që drejtojnë një sport që është në programin e Lojërave Olimpike, me një të drejtë vote secili. Këta përfaqësues të autorizuar nga secila federatë duhet të jenë anëtar aktiv të organit ekzekutiv të federatës së tillë (duke përfshi Presidentin e federatës së tillë, nëse është e mundur). Në pajtim me Kartën Olimpike, këto Federata / përfaqësuesit e tyre duhet të pérbejnë shumicën votuese të Asamblesë së Përgjithshme.
- iii. Dy përfaqësues nga federata kombëtare e anëtarësuar në Federatën Ndërkombëtare që drejtojnë sportet që nuk janë të përfshira në programin e Lojërave Olimpike, që janë anëtarë të KOK-ut, me një vote secili. Këta përfaqësues të autorizuar nga secila federatë duhet të jenë anëtar aktiv të organit ekzekutiv të federatës së tillë (duke përfshirë Presidentin e federatës së tillë, nëse është e mundur).
- iv. Një përfaqësues nga çdo organizatë tjeter sportive e theksuar në Nenin 3.1.d të këtij Statuti, që janë anëtarë të KOK-ut, me një votë secili. Këta përfaqësues të autorizuar nga secila organizatë duhet të jenë anëtarë aktiv të organit ekzekutiv të organizatës së tillë (duke përfshiri, nëse është e mundur, Presidentin e organizatës së tillë)
- v. Dy përfaqësues të sportistëve (nëse është e mundur, një mashkull dhe një femër) të zgjedhur nga Komisioni i sportistëve të KOK-ut i formuar në pajtim me udhëzimet e KON-it ose të Asamblesë së Përgjithshme, me një votë secili. Këta përfaqësues të zgjedhur duhet të kenë marr pjesë së paku në njëren nga tri edicionet e Lojërave Olimpike (Vërejtje: kjo kërkesë do të aplikohet vetëm pas pjesëmarrjes së parë të KOK-ut në Lojërat Olimpike).
- vi. Anëtaret tjerë në pajtim me Nenin 3.2.a. të këtij Statuti, pa të drejtë vote.
- vii. Anëtaret e nderit të KOK-ut, pa të drejtë vote.

2. Autorizimet e Asamblesë së Përgjithshme:

a. Asambleja e Përgjithshme është organi drejtues suprem i KOK-ut.

B.H

b. Asambleja e Përgjithshme i ka autorizimet si në vijim:

- i. Adoptimi i agjendës së mbledhjes dhe të procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
- ii. Përcaktimi dhe aprovimi i planit strategjik dhe i politikave të përgjithshme të KOK-ut.
- iii. Dëgjimi, shqyrtimi dhe aprovimi i raportit vjetor i aktiviteteve të KOK-ut të prezantuara nga Bordi Ekzekutiv i KOK-ut, si dhe dëgjimi, shqyrtimi dhe aprovimi i objektivave dhe planit veprues për vitin vijues të propozuar nga Bordi Ekzekutiv i KOK-ut.
- iv. Shqyrtimi dhe aprovimi i gjendjes financiare të audituar të vitit të kaluar dhe të shqyrtoj e aprovoj buxhetin vjetor për vitin vijues të propozuar nga Bordi Ekzekutiv i KOK-ut.
- v. Zgjedh anëtarët e Bordit Ekzekutiv të KOK-ut.
- vi. Zgjedh anëtarët e Komisionit të Pavarur Zgjedhor për Asamblenë e Përgjithshme Zgjedhore.
- vii. Zgjedh auditorin që do të vlerësoj gjendjen financiare vjetore të KOK-ut.
- viii. Aprovon ose refuzon anëtarësimin e çdo anëtarit të KOK-ut.
- ix. Vendos për përashtimin e çdo anëtarit të KOK-ut (me vendimin e marr nga se paku dy te tretat (2/3) e votave të delegatëve votues prezent në Asamblenë e Përgjithshme) dhe ekskluzivisht sipas mënyrës së apelimit, kur suspendohet një anëtar me vendimin e Bordit Ekzekutiv në pajtim me Nenin 3.7.c të këtij Statuti.
- x. Definon pagesën e anëtarësimit, nëse është e aplikueshme.
- xi. Pranon çfarëdo asistence materiale, financiare, sponzorizimi ose donacioni në pajtim me këtë Statut.
- xii. Shqyrton dhe adopton ketë Statut dhe çdo amendament të ardhshëm të këtij Statuti (me vendimin e marr nga së paku dy të tretat (2/3) e votave të delegatëve votues prezent në Asamblenë e Përgjithshme).
- xiii. Shqyrton dhe aprovon çdo akt nënligjor plotësues ose irregulloret e brendshme të propozuara nga Bordi Ekzekutiv, të cilat nuk janë në kontradiktë me këtë Statut dhe me Kartën Olimpike.
- xiv. Interpreton këtë Statut (subjekt i rregullave te aplikueshme të Kartës Olimpike) nëse ka raste të tilla.
- xv. Vendos për shpërbërjen e KOK-ut (në prezencën e një kuorumi prej së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve votues dhe me vendimin e marr nga se paku dy të tretat (2/3) e votave të delegatëve votues prezent në Asamblenë e Përgjithshme).
- xvi. Realizon çdo të drejtë tjetër bazuar në këtë Statut.
- xvii. Në përgjithësi, vendos në të gjitha çështjet në agjendën e saj dhe për çdo çështje e cila mund të mos jetë në këtë Statut, por që mund të jetë subjekt i Kartës Olimpike.

3. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme:

- a. Asambleja e Përgjithshme duhet të takohet në sesione të zakonshme së paku një here në vit. Data e mbledhjes duhet të vendoset nga Bordi Ekzekutiv.

B. ff

- b. Asambleja e Përgjithshme ftohet me ftesën e nënshkruar nga Presidenti dhe i dërgohet anëtarëve se paku tridhjete (30) dite para datës së mbledhjes, duke shënuar datën, orën, vendin dhe agjendën e mbledhjes, duke përfshirë edhe të gjitha dokumentet e domosdoshme.
- c. Asambleja e Përgjithshme mund të procedoj në mënyrë të rregullt për çështjet e parapara me agjendën e saj. Propozimet nga anëtarët lidhur me agjendën duhet të arrijnë të Presidenti dhe/ose të Sekretari i Përgjithshëm, jo me vonë se njëzet e një (21) dite para datës së mbledhjes. Nëse duhet të bëhet ndonjë modifikim në agjendë, agjenda përfundimtare duhet t'i komunikohet anëtarëve jo me vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së mbledhjes.
- d. Një mbledhje e jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme mund të ftohet kurdo që është e domosdoshme me kërkesën e Presidentit, dhe/ose të Bordit Ekzekutiv dhe/ose të së paku pesëdhjetë përqind plus një (50% + 1) të anëtarëve votues të Asamblesë së Përgjithshme, duke përfillur procedurat e njëjtë dëshmi e fundit.
- e. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të udhëhiqen nga Presidenti. Ne mungesë të tij ose të pamundësisë së Presidentit, Nën-Presidenti i Parë (ose në mungese ose pamundësi të Nën-Presidentit të parë, ose në mungesë ose në pamundësi të të dyve, Nën-Presidenti i Tretë etj.) do të udhëheqë mbledhjen.
- f. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë Statut, kuorumi i kërkuar për Asamblenë e Përgjithshme është se paku gjysma (50% +1) e delegatëve votues, duke përfshirë shumicën votuese të delegatëve të federatave të sporteve Olimpike. Nëse ky kuorum nuk mund të arrihet, mbledhja duhet të shtyhet për shtatë (7) ditë. Nëse kuorumi nuk arrihet as në mbledhjen e dytë, mbledhja do të mbahet, nëse prezent janë së paku një e treta (1/3) e anëtarëve votues, me kusht që shumica e votuesve janë delegatët e federatave të sporteve Olimpike.
- g. Vendimet do të merren nga Asambleja e Përgjithshme nga së paku gjysma (50% +1) e votave të delegatëve votues që janë prezent, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë Statut.
- h. Në rast të barazimit, Kryesuesi i mbledhjes do të ketë votën vendimtare.
- i. Votimi behet me vota të hapura ose të fshehta ashtu si vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, përveç për zgjedhjen e anëtarëve dhe sankzionet kundër anëtarëve, votimi do te jete me vota të fshehta.
- j. Votimi Proxy (me autorizim) nuk lejohet.
- k. Shumica e votuesve të Asamblesë së Përgjithshme duhet të përbëhet gjithmonë nga delegatët e federatave kombëtare të anëtarësuara në Federatat Ndërkombëtare që drejtojnë sportet që janë në programin e Lojëra Olimpike.
- l. Për çështjet që kanë të bëjnë me Lojërat Olimpike, merren në konsideratë vetëm votat e delegatëve të federatave kombëtare anëtarë të Federatave Ndërkombëtare që drejtojnë sportet e përfshira në programin e Lojëra Olimpike.
- m. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv duhet të bëhet çdo katër (4) vjet, brenda gjashtë (6) muajve pas Lojëra Verore Olimpike, gjatë mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme e cila duhet ta përfshijë në agjendën e saj këtë pikë.
- n. Zgjedhjet duhet të bëhen në pajtim me procedurat e përmendura me këtë Statut.
- o. Kopjet e procesverbaleve të mbledhjeve ku janë mbajtur zgjedhjet ose kur janë bërë zëvendësimet e anëtarëve duhet të dërgohen në KON. Të gjitha dokumentet duhet të certifikohen si kopje të vërteta nga Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOK-ut.
- p. Sekretari i Përgjithshëm (ose në mungesë të tij/saj, një anëtar i Bordit Ekzekutiv ose i Asamblesë së Përgjithshme i përcaktuar nga Presidenti) është përgjegjës për

formulimin e procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbal i duhet të shpërndahet tek të gjithë anëtarët brenda tridhjete (30) ditëve pas mbledhjes.

4. Procedurat Zgjedhore për anëtarët e Bordit ekzekutiv:

Procedurat për zgjedhje duhet të jenë si ne vijim:

- a. Në Asamblenë e Përgjithshme para asaj zgjedhore, Asambleja e Përgjithshme zgjedh një komision të pavarur zgjedhor i cili do të jetë plotësisht përgjegjës për zhvillimin, monitorimin dhe udhëheqjen e procesit zgjedhor në tërësi (nga pranimi i nominimeve deri te shpallja e rezultateve finale). Ky komision i pavarur zgjedhor duhet të përbëhet nga tre (3) anëtarë, duke përfshi Kryesuesin dhe dy (2) anëtarë rezerve (nëse është e nevojshme). Asnjë nga këta anëtarë nuk mund te jete kandidatë për organe ekzekutive. Ata duhet të jenë të pavarur dhe neutral, biografi legjitime, të kenë integritet dhe mos të kenë konflikt interes me zgjedhjet.
- b. Formularët e nominimit duhet të dërgohen tek të gjithë anëtarët votues të Asamblesë së Përgjithshme jo me vonë se tridhjete (30) ditë para zgjedhjeve, së bashku me paralajmërimin për mbledhje.
- c. Nominimet mund të dorëzohen në komisionin e pavarur zgjedhor nga çdo anëtar votues i Asamblesë së Përgjithshme jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë para zgjedhjeve.
- d. Të nominuarit për pozitën e Presidentit duhet të jenë anëtarë ekzekutiv të një Federatë Kombëtare të anëtarësuar në një Organizatë Ndërkombëtare e cila drejton një sport të përfshirë në programin e Lojëra Olimpike (në momentin kur organizohen zgjedhjet në KOK).
- e. Kur ata i dorëzojnë nominimet e tyre, të nominuarit për pozitën e Presidentit duhet po ashtu të dërgojnë të komisioni i pavarur zgjedhor një përbledhje të shkurtër të vizionit dhe programit të tyre, i cili do t'i dërgohet anëtarëve me të drejtë vote, jo me vonë se 6 ditë para zgjedhjeve.
- f. Komisioni zgjedhor i pavarur do të shqyrtoj nominimet e pranuara dhe do të njoftoj anëtarët votues të Asamblesë së Përgjithshme për emrat dhe biografinë e shkurtër të kandidatëve të përshtatshëm jo më vonë se dhjetë (10) ditë para zgjedhjeve. Çdo kundërshtim/apel objektiv nga ndonjë anëtar votues duhet të dorëzohet të Komisioni i pavarur zgjedhor jo më vonë se tetë (8) ditë para zgjedhjeve. Komisioni i pavarur zgjedhor do të shqyrtoj kundërshtimin/apelin dhe do të merr vendimin jo më vonë se gjashtë (6) ditë para zgjedhjeve dhe, në këtë rast, do të informoj të gjithë anëtarët votues. Në rast të çfarëdo dileme për përshtatshmërinë apo mos përshtatshmërinë e kandidatit, komisioni i pavarur zgjedhor do të referoj rastin në Asamblenë e Përgjithshme për vendimin final të Asamblesë së Përgjithshme para procedimit me votime.
- g. Zgjedhjet duhet të organizohen për çdo pozitë, njëra pas tjetrës dhe me vota të fshehta.
- h. Komisioni i pavarur zgjedhor duhet të përgatitë kutinë transparente të votimit dhe fletët e votimit që do tu jipen delegatëve votues të Asamblesë së Përgjithshme.
- i. Komisioni i pavarur zgjedhor duhet të sqaroj procedurën zgjedhore dhe do të përgjigjet ose të sqaroj çdo pyetje para fillimit të procedurës së votimit.
- j. Pasi të gjithë delegatet votues prezent janë ftuar të votojnë nga komisioni i pavarur zgjedhor, komisioni i pavarur zgjedhor do të hap kutinë e votimit dhe do ti numëroj votat publikisht.

- k. Nëse është një ose dy kandidatë për një pozicion, kandidati që merr së paku 50% + 1 të votave valide do të deklarohet i zgjedhur.
- l. Nëse ka më shumë se dy kandidat dhe asnjeri nuk merr së paku 50% + 1 të votave valide në raundin e parë, atëherë do të organizohet raundi i dytë midis dy kandidatëve që kanë marr numrin më të madh të votave valide në raundin e pare. Në këtë raundin e dytë, kandidati që merre 50% + 1 të votave valide do të deklarohet i zgjedhur.
- m. Pas zgjedhjes, Presidenti mund të propozoj tre anëtarë të zgjedhën si anëtarë të Bordit Ekzekutiv nga e njëjta Asamble e Përgjithshme zgjedhore, në pajtim me Nenin 6.1.a.vi të këtij Statuti.
- n. Komisioni i pavarur zgjedhor do të shpall rezultatet e zgjedhjeve dhe do të shqyrtoj dhe merr vendime për çdo çështje/ankesë që mund të ngritët nga cilido delegat votues para mbylljes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- o. Të dy gjinitë duhet të jenë të përfaqësuara në Bordin Ekzekutiv.
- p. Siç përmendet në Kartën Olimpike, përfaqësuesit e zgjedhur të federatave kombëtare anëtare të Federatave Ndërkombe të drejtojnë sportet e përfshira në programin e Lojëra Olimpike, duhet të përbejnë shumicën votuese në Bordin Ekzekutiv.

NENI 6: BORDI EKZEKUTIV

1. Përbërja e Bordit Ekzekutiv:

- a. Bordi Ekzekutiv duhet të përbëhet nga anëtarët votues të Asamblesë së përgjithshme të zgjedhur si në vijim:
 - i. Presidenti
 - ii. Nën-Presidenti i Parë
 - iii. Nën-Presidenti i Dytë
 - iv. Nën-Presidenti i Tretë
 - v. Nën-Presidenti i Katërt
 - vi. Jo me shume se 10 anëtarë, duke përfshi së paku një përfaqësues të sportistëve të zgjedhur nga Komisioni i sportistëve të KOK-ut ose nga Asambleja e Përgjithshme dhe tre anëtarë të propozuar nga Presidenti (i posa zgjedhur) për tu zgjedhur në Asamblenë e njëjtë zgjedhore.
- b. Anëtarët e KON-it nga Kosova, nëse ka, është (janë) anëtarë ex-officio (sipas funksionit) të Bordit Ekzekutiv me të drejtë vote.
- c. Brenda këtyre 15 anëtarëve votues të zgjedhur në Bordin Ekzekutiv, përfaqësuesit e federatave kombëtare anëtare të Federatave Ndërkombe të drejtojnë sporte të përfshira në programin e Lojëra Olimpike duhet gjithmonë të përbejnë shumicën votuese të Bordit Ekzekutiv.
- d. Sekretari i Përgjithshëm dhe Arkëtari duhet të jenë administrator profesional (me kontratë pune) të cilët duhet të demonstrojnë kualifikime përkatëse dhe shkathtësi të realizojnë këto funksione ne rregull. Ata duhet të emërohen (të largohen) nga

B.H

Bordi Ekzekutiv sipas propozimit të Presidentit. Ata duhet të përcjellin mbledhjet e Bordit Ekzekutiv me të drejtë të diskutojnë por pa të drejtë vote.

- e. Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm duhet të plotësojnë kushtet në vijim:
 - i. Ai/ajo duhet të jetë qytetar/shtetas i Kosovës.
 - ii. Ai/ajo duhet të ketë të përfunduar Universitetin ose shkollimin e lartë të shkallës së njëjtë.
 - iii. Ai/ajo duhet të ketë përvjoje minimale në Lëvizjen sportive dhe njoħuri tē Lëvizjes Olimpike.
 - iv. Ai/ajo duhet të jetë në gjendje të flas së paku njérën nga dy gjuhët zyrtare tē KON-it (Anglishten ose Frēngjishten).

2. Mandati i anëtarëve tē zgjedhur tē Bordit Ekzekutiv:

Anëtarët e Bordit Ekzekutiv duhet tē zgjedhën me mandat që nuk tejkalon 4 vite, sipas procedurave tē parapara pér zgjedhje në këtë Statut. Ata mund tē rizgjidhen (natyrish nëse dëshmojnë se ende i plotësojnë kushtet e kërkuara).

3. Vendet vakante:

- a. Një anëtar i Bordit Ekzekutiv humb tē drejtën e anëtarit në rast tē:
 - i. Vdekjes.
 - ii. Dorëheqjes.
 - iii. Mungesës së pa arsyetuar në tri (3) mbledhje tē njëpasnjëshme te Bordit Ekzekutiv.
 - iv. Largimi ose përjashtimi sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nga shumica e së paku tē dy tē tretave (2/3) tē votave tē delegatëve votues prezent në Asamblenë e Përgjithshme pasi tē jetë dhënë mundësia e arsyeshme delegatit në fjalë pér tu dëgjuar nga Asambleja e Përgjithshme.
- b. Çdo vend vakant i paraqitur në Bordin ekzekutiv do tē plotësohet përkohësisht me zgjedhjen e një anëtarri tē ri nga Bordi Ekzekutiv në bazë tē propozimit të Presidentit, deri në Asamblenë e Përgjithshme tē rrudhës në tē cilën pozicioni do tē plotësohet me zgjedhjen e anëtarit tē ri pér periudhën e mbetur tē mandatit.

4. Autorizimet e Bordit Ekzekutiv:

- a. Të menaxhoj, administroj dhe udhëheqë KOK-un në pajtim me këtë Statut dhe me planin strategjik, buxhetin dhe politikat e përgjithshme tē aprovuara nga Asambleja e Përgjithshme. Bordi Ekzekutiv i përgjigjet pér punën e tij Asamblesë së Përgjithshme.
- b. Të bëjë propozime në Asamblenë e Përgjithshme pér definimin e planit strategjik, politikave tē përgjithshme dhe planin e veprimit tē KOK.
- c. Të zbatoj rezolutat e kaluara nga Asambleja e Përgjithshme.
- d. Të përgatis gjendjen financiare tē audituar, buxhetin vjetor dhe raportet e KOK-ut pér tu paraqitur në Asamblenë e Përgjithshme pér aprovim.

- e. Të menaxhoj pasurinë dhe fondet e KOK-ut sipas aprovimit nga Asambleja e Përgjithshme.
- f. Të mbroj interesin e Lëvizjes Olimpike e Sportive në Kosovë dhe të punoj intensivisht të arrihen qëllimet dhe objektivat e KOK-ut.
- g. Të përcaktoj dhe zgjedh pjesëmarrësit në Lojëra Olimpike dhe në garat multi-sportive regionale, kontinentale dhe botërore nën patronatin e KON-it në të cilat Kosova merr pjesë, pas propozimeve të Federatave Kombëtare dhe në bashkëpunim të ngushtë me to.
- h. Të siguroj asistencë dhe këshilla për Federatat Kombëtare (brenda mjeteve të tij) me qellim të përmirësojnë zhvillimin dhe operimin e tyre, nëse është e nevojshme.
- i. Të formojnë dhe monitorojnë komisionet dhe/ose grupet punuese nëse duket e nevojshme të asistohet në arritjen e objektivave të KOK, dhe të nominoj anëtarët e komisioneve të tillë dhe/ose të grupeve punuese.
- j. Të bëjë propozime për anëtarësim të ndonjë anëtari në Asamblenë e Përgjithshme për vendim.
- k. Të hartojë aktet nënligjore dhe rregulloret e brendshme, nëse është e nevojshme, në vijë me këtë Statut dhe me Kartën Olimpike, dhe ti dorëzoj ato në Asamblenë e Përgjithshme për aprovim.
- l. Të krijoj dhe të zhvilloj marrëdhënie harmonike dhe të frytshme në nivelin ndërkombëtar, me KON-in dhe organizata tjera sportive regionale, kontinentale dhe ndërkombëtare si dhe në nivelin kombëtar me autoritetet relevante.
- m. Të ndërmerr veprime disiplinore siç është përmendur në këtë Statut.
- n. Të realizoj çdo detyrë tjetër që parashihet me këtë Statut ose që delegohet nga Asambleja e Përgjithshme.

5. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv:

- a. Bordi Ekzekutiv duhet të takohet së paku katër (4) herë në vit.
- b. Takimet urgjente të Bordit Ekzekutiv mund të ftohen nga Presidenti dhe/ose me kërkesën e gjysmës ($50\% + 1$) të anëtarëve të Bordit Ekzekutiv.
- c. Mbledhjet duhet të ftohen dhe udhëhiqen nga Presidenti. Në mungesë ose pamundësi, Nën-Presidenti i Parë (ose në mungesë ose në pamundësi të Nën-Presidentit t Parë, Nën-Presidenti i Dytë, ose në mungesë ose pamundësi të dyve, Nën-Presidenti i Tretë etj.) do ta thërras dhe udhëheqë mbledhjen.
- d. Mbledhjet e Bordit Ekzekutiv do të ftohen me ftesë për të gjithë anëtarët e Bordit Ekzekutiv jo me vonë se shtatë (7) ditë para mbledhjes duke caktuar datën, orën, vendin dhe agjendën e mbledhjes dhe duke përfshirë edhe të gjitha dokumentet e nevojshme.
- e. Kuorumi i kërkuar për një mbledhje të Bordit Ekzekutiv është së paku gjysma ($50\% + 1$) e anëtarëve votues të Bordit Ekzekutiv.
- f. Të gjithë anëtarët votues të Bordit Ekzekutiv duhet të kenë të drejtën e një vote secili.
- g. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve votues prezent.
- h. Në rast të barazimit, Kryesuesi i mbledhjes e ka votën vendimtare.
- i. Votimi duhet të bëhet me ngritje të dorës ose me votim të fshehtë nëse vendos Bordi Ekzekutiv.

B.H

- j. Sekretari i Përgjithshëm (ose në mungesë të tij/saj një anëtar i Bordit Ekzekutiv i përcaktuar nga Kryesuesi) është përgjegjës për formulimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit Ekzekutiv. Prosesverbalit duhet ti shpërndahet të gjithë anëtarëve të Bordit Ekzekutiv brenda shtatë (7) ditëve pas mbledhjes.

6. Përgjegjësitë e Presidentit:

- a. Presidenti është përfaqësuesi legal i KOK-ut në Kosovë dhe jashtë.
- b. Presidenti duhet të veproj dhe të nënshkruaj si përfaqësues ligjor i KOK-ut.
- c. Presidenti duhet të bashkë-nënshkruaj me Sekretarin e Përgjithshëm dhe/ose me Arkëtarin çdo autorizim financiar ose shpenzim.
- d. Presidenti duhet të ftoj dhe udhëheqë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Bordit Ekzekutiv.
- e. Presidenti duhet të siguroj mbikëqyrjen e këtij Statuti dhe të Kartës Olimpike në Kosovë.
- f. Presidenti duhet të promovoj parimet Olimpike dhe sjelljet etike në kuadër të Lëvizjes Olimpike në Kosovë.
- g. Presidenti duhet të punoj në ruajtjen dhe përforcimin e marrëdhënieve harmonike me të gjitha autoritetet, institucionet, partnerët dhe palët e interesit në Kosovë dhe jashtë.
- h. Presidenti duhet të përformoj, kohë pas kohe, çdo funksion tjeter që mund të përshkruhet nga Asambleja e Përgjithshme ose nga Bordi Ekzekutiv.

7. Përgjegjësitë e Nën-Presidentëve:

- a. Nën-Presidenti, sipas radhës (i Pari, i Dytë, i Treti dhe i Katërti) duhet të performojë detyrat dhe të përbushin përgjegjësitë e Presidentit në rast të mungesës dhe pamundësisë.
- b. Nën-Presidenti duhet aktivisht të merr pjesë në punën e organeve drejtuese të KOK-ut.
- c. Nën-Presidenti duhet të përformoj, kohë pas kohe, çfarëdo funksioni që mund ti përshkruhet nga Asambleja e Përgjithshme ose nga Bordi Ekzekutiv ose nga Presidenti.

8. Përgjegjësitë e anëtarëve të tjera të Bordit Ekzekutiv:

- a. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv duhet aktivisht të marrin pjesë në punën e organeve drejtuese të KOK-ut.
- b. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv duhet të përformojnë, kohë pas kohe, çfarëdo funksioni që mund ti përshkruhet nga Asambleja e Përgjithshme, ose nga Bordi Ekzekutiv ose nga Presidenti.

9. Përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm:

- a. Sekretari i Përgjithshëm duhet të jetë administrator profesionist me një kontratë pune i cili duhet të demonstroj kualifikime të përshtatshme dhe shkathtësi të kryej funksionin e tillë me sukses. Ai/ajo do të emërohen (dhe

b. #

largohen) nga Bordi Ekzekutiv me propozimin e Presidentit. Ai/ajo do të përcjell mbledhjet e Bordit Ekzekutiv me të drejtë të diskutimit por pa të drejtë vote.

- b. Sekretari i Përgjithshëm duhet të menaxhoj, administratën dhe stafin e KOK-ut dhe të monitoroj e mbikëqyrë tërë punën administrative sipas direktivave të Asamblesë së Përgjithshme, të Bordit Ekzekutiv dhe të Presidentit.
- c. Sekretari i Përgjithshëm duhet të realizoj të gjitha aranzhimet e nevojshme për mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Bordit Ekzekutiv.
- d. Sekretari i Përgjithshëm duhet të përpiloj dhe të mbaj të gjitha të dhënat dhe procesverbalet e mbledhjeve të Asambleve të Përgjithshme dhe të Bordit Ekzekutiv.
- e. Sekretari i Përgjithshëm duhet të mbaj regjistrin e anëtarëve të përditësuar dhe në disponim në çdo kohë.
- f. Sekretari i Përgjithshëm duhet të koordinoj punën e komisioneve dhe të grupeve punuese.
- g. Sekretari i Përgjithshëm duhet të kryej, kohë pas kohe, çdo funksion tjetër që mund ti përshkruhet nga Asambleja e Përgjithshme ose nga Bordi Ekzekutiv ose nga Presidenti.

10. Përgjegjësítë e Arkëtarit:

- a. Arkëtari duhet të jetë një administrator profesionist me një kontratë pune i cili duhet të demonstroj kualifikime të përshtatshme dhe shkatërsi për kryerjen e përshtatshme të funksionit të tillë. Ai/ajo do të emërohet (dhe largohet) nga Bordi Ekzekutiv pas propozimit të Presidentit. Ai/ajo duhet të përcjellë mbledhjet e Bordit Ekzekutiv me të drejtë të diskutoj por pa të drejtë vote.
- b. Arkëtari duhet të pranoj të gjitha pagesat, kuotizimet çdo fond ose pasuri të paguar ose si donacion për KOK-un.
- c. Arkëtari duhet ti depozitoj të gjitha fondet e pranuara në një bankë të besueshme, në emër dhe si kreditim i KOK-ut, ashtu siç është aprovuar nga Bordi Ekzekutiv.
- d. Arkëtari duhet të mbaj dhe të administroj llogaritë e KOK-ut.
- e. Arkëtari duhet të mbaj në rregull, saktë dhe të përditësuara të gjitha të dhënat për shpenzimet, të hyrat dhe transaksionet tjera financiare të KOK-ut të disponueshme në çdo kohë për Bordin Ekzekutiv.
- f. Arkëtari duhet të përgatis të gjitha raportet dhe buxhetet vjetore për Bordin Ekzekutiv dhe për Asamblenë e Përgjithshme.
- g. Arkëtari duhet të siguroj se gjendja financiare e KOK është audituar në rregull dhe për çdo vit, nga Auditori i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme.
- h. Arkëtari duhet të kryej edhe funksione tjera kohë pas kohe ashtu si i përshkruhen nga Asambleja e Përgjithshme, ose nga Bordi Ekzekutiv, ose nga Presidenti.

NENI 7: KOMISIONET DHE GRUPET PUNUESE

1. Me qëllim të lehtësimit, asistimit dhe përforcimit të punës së KOK-ut, Bordi Ekzekutiv mund të formoj komisione dhe grupe punuese, nëse është e nevojshme.

B. H

2. Bordi Ekzekutiv duhet, në veçanti, të formoj komisionet në vijim (dhe kushtet korresponduese të referencave të secilit komision):
 - a. Komisioni i Sportistëve (subjekt i udhëzimeve të KON-it)
 - b. Komisioni Etik
 - c. Komisioni për Financa dhe Auditim
 - d. Komisioni Ligjor
 - e. Komisioni për Marketing
 - f. Komisioni Mjekësor
 - g. Komisioni Femra dhe Sporti
 - h. Komisioni i Sportit
 - i. Komisioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare
3. Bordi Ekzekutiv duhet të përcaktoj përbërjen, autorizimet dhe operimet e komisioneve të tilla dhe të grupeve punuese.
4. Bordi Ekzekutiv nuk mund të transferoj asnjë autorizim vendim-marrës në komisione dhe grupe punuese.
5. Komisioni i Sportistëve të KOK-ut duhet të formohet dhe të operoj në pajtim me udhëzimet e KON-it.

**NENI 8:
AKADEMIA OLIMPIKE E KOSOVËS**

1. KOK-u mund të themeloj Akademinë Olimpike të Kosovës nën ombrellën e vet.
2. Akademia Olimpike e Kosovës do të operoj në pajtim me kushtet specifike të referencës të adoptuara nga KOK-u.

**NENI 9:
FINANCAT**

1. Financat e KOK-ut duhet të rrjedhin nga burimet në vijim:
 - a. Mbështetja financiare nga KON-i; nga Solidariteti Olimpik dhe nga organizatat tjera të Lëvizjes Olimpike.
 - b. Mbështetja financiare e alokuar nga autoritetet relevante të Kosovës.
 - c. Kuotizimi për anëtarësim bazuar në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme (nëse është e aplikueshme).
 - d. Të hyrat që rrjedhin nga Marketingu dhe aktivitetet sponsorizuese dhe përdorimi i emrit dhe emblemës së KOK-ut në pajtim me Kartën Olimpike dhe me këtë Statut.
 - e. Donacionet dhe grantet e pranuara nga Bordi Ekzekutiv dhe nga Asambleja e Përgjithshme.
 - f. Çdo burim tjetër legjitim në pajtim me Kartën Olimpike dhe me ketë Statut.

B.H

2. Kontributet dhe fondet specifike të pranuara nga entitetet kombëtare e ndërkontrolluese duhet të shfrytëzohen në mënyrë strikte për qëllimin e arritjes së objektivit dhe aktiviteteve të KOK-ut, në pajtim me këtë Statut dhe me Kartën Olimpike.
3. Fondet specifike të alokuara nga programet e Solidaritetit Olimpik duhet të përdoren vetëm për qëllimin e programit të përcaktuar nga Solidariteti Olimpik.
4. Viti finansiar i KOK-ut fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të vitit të njëjtë.

NENI 10:

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Çdo pakënaqësi e ngritur brenda KOK-ut ose KOK-ut dhe anëtarëve të tij e ndërlidhur me sport ose çështje institucionale do të zgjidhet nga organet drejtuese kompetente të KOK-ut (në konsultim të ngushtë dhe në koordinim paraprak me federatat përkatëse ndërkontrolluese në rastet kur përfshihet federata kombëtare), dhe jashtë në Gjykatat e zakonshme. Rasti duhet ti referohet Bordit Ekzekutiv dhe/ose Asamblesë së Përgjithshme si autoritet suprem i KOK-ut. Asambleja e Përgjithshme mund të vendos të krijoj një vendim final për mosmarrëveshjen në fjalë, ose Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të formoj një këshillë specifike, një mediator ose trup arbitrazhi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
2. Çdo vendim final i bërë nga Asambleja e Përgjithshme për çështjen në fjalë ose nga Këshilli, nga mediatori ose nga organi i arbitrazhit i formuar nga Asambleja e Përgjithshme për atë qellim mund të dorëzohet ekskluzivisht në mënyrën e apelit në Gjykatën e Arbitrazhit për Sport (CAS) në Llozanë, Zvicër, e cila do të zgjidh çështjet definitivisht në pajtim me Kodin e Arbitrazhit të Ndërlidhur me Sport. Koha e limituar për apel është njëzet e një ditë (21 ditë) pas pranimit të vendimit për të cilin bëhet fjalë.

NENI 11: SHPËRBËRJA

1. KOK-ut mund të shpërbëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme në prezencën e një kuorumi të së paku dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve votues dhe me rezolutën e pranuar nga së paku dy të tretat (2/3) e votave të delegatëve votues prezent.
2. Në rast të shpërbërjes, të gjitha obligimet dhe rezervat e fituara ligjërisht në emër të KOK-ut, në tërësi do të dorëzohen dhe fondi do ti jipet donacion pasardhësit ligjor ose, nëse nuk ekziston, një organizate që ka objektiva përafërsisht të njëjta dhe në

6.4


bazë të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme e cila paraprakisht konsultohet dhe koordinohet me KON-in.

NENI 12:
DISPOZITAT FINALE

1. Statuti i KOK duhet, gjatë tërë kohës, të jetë në pajtim me Kartën Olimpike të cilës duhet ti referohet shprehimisht. Nëse ka ndonjë dilemë në rëndësinë ose interpretimin e këtij Statuti, ose nëse ka ndonjë kontradiktë midis këtij Statuti dhe Kartës Olimpike, mbizotëron kjo e fundit.
2. Ky Statut duhet të adoptohet, dhe pastaj edhe të amendamentohet nga Asambleja e Përgjithshme me vendimin e dy të tretave (2/3) të votave të delegatëve votues prezent në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
3. Statuti i KOK-ut, dhe çdo ndryshim pasues ose amendamentim i Statutit të KOK-ut, duhet të dorëzohet në KON për aprovim.
4. Statuti bëhet efektiv posa të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e KOK-ut dhe do të zëvendësoj dhe mbizotëroj çdo Statut të mëparshëm të KOK-ut.

Data e miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e KOK-ut: 24 Shkurt 2016

Nënshkruar nga:



Presidenti i
Komitetit Olimpik të Kosovës



Sekretari i Përgjithshëm i
Komitetit Olimpik të Kosovës